

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJE



DREJTORIA E SHERBIMEVE DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

**MBI DOMOSDOSHMERINË E SIGURIMIT TË SHËRBIMIT TË PRANIMIT,
PESHIMIT, TRAJTIMIT DHE/OSE DEPOZITIMIT FINAL TË MBETJEVE URBANE
TË GJENERUARA NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË KRUJË**

I. HYRJE

Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane përbën një nga funksionet bazë dhe të detyrueshme të njësisë të vetëqeverisjes vendore, i lidhur drejtpërdrejt me garantimin e shëndetit publik, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e burimeve natyrore dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe evropiane në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Në kushtet e rritjes së vazhdueshme të gjenerimit të mbetjeve, urbanizimit progresiv, zhvillimit ekonomik dhe flukseve sezonale të popullsisë, siguri i një sistemi funksional, të qëndrueshëm dhe ligjërish të përputhshëm për trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve përbën një domosdoshmëri të padiskutueshme institucionale.

Bashkia Krujë, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për organizimin dhe garantimin e shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve, ka detyrimin ligjor të sigurojë që mbetjet urbane të gjeneruara në territorin e saj të trajtohen dhe depozitohen në objekte të licencuara, të pajisura me infrastrukturën teknike dhe mjedisore të nevojshme.

Objekti i këtij relacioni është argumentimi teknik, juridik dhe mjedisor i nevojës për kontraktimin e shërbimit të pranimit, peshimit, trajtimit dhe/ose depozitimit final të mbetjeve urbane, si dhe evidentimi i mungesës së alternativave të tjera funksionale që garantojnë vazhdimësinë e këtij shërbimi publik.

II. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

Detyrimi i Bashkisë Krujë për organizimin dhe garantimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor dhe rregullator.

- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe administrimit të shërbimeve publike vendore, duke përfshirë organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane.
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, përcakton parimet themelore të menaxhimit të mbetjeve, përgjegjësitë institucionale, hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, kërkesat për trajtimin dhe depozitimin final, si dhe detyrimet për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

- Ky ligj sanksionon se mbetjet duhet të menaxhohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa përdorur procese ose metoda që mund të shkaktojnë ndikime negative në mjedis, veçanërisht në ujëra, tokë, ajër, biodiversitet dhe peizazh.
- Gjithashtu, Ligji nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, vendos detyrimin për parandalimin dhe minimizimin e ndotjes, kontrollin e ndikimeve mjedisore dhe zbatimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligjin nr. 57/2025 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i cili përcakton parimet, përgjegjësitë institucionale dhe organizimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035, miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020;
- Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, miratuar me Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit;
- aktet nënligjore dhe dokumentet strategjike që rregullojnë organizimin territorial të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.

Në aspektin procedural, Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ngarkon autoritetet kontraktore me detyrimin për planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit të nevojshme për garantimin e funksioneve dhe shërbimeve publike.

Kuadri kombëtar plotësohet nga aktet nënligjore për menaxhimin e mbetjeve, kushtet e lejeve mjedisore, dokumentet strategjike kombëtare dhe planet rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Për më tepër, Republika e Shqipërisë ka detyrimin e përafrimit gradual të legjislacionit me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, veçanërisht me:

- Direktivën 2008/98/EC mbi mbetjet (Waste Framework Directive)
- Direktivën 1999/31/EC mbi depozitimin e mbetjeve në landfill
- Direktivën (EU) 2018/851 për ndryshimin e Direktivës Kuadër të Mbetjeve.

Këto instrumente ligjore kërkojnë që depozitimi final të konsiderohet si opsioni i fundit në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe të realizohet vetëm në objekte të projektuara, ndërtuara dhe operuara sipas standardeve të sigurisë mjedisore.

III. GJENDJA EKZISTUESE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË KRUJË

Bashkia Krujë administron një territor me karakteristika të kombinuara urbane dhe rurale, ku gjenerimi i mbetjeve urbane lidhet drejtpërdrejt me aktivitetet familjare, tregtare, institucionale, turistike dhe shërbimet publike.

Sistemi aktual i menaxhimit të mbetjeve përfshin proceset e grumbullimit, transportit dhe transferimit të mbetjeve drejt objektit të autorizuar për trajtim dhe depozitim final.

Bazuar në të dhënat historike të prodhimit të mbetjeve dhe në analizat e kryera nga strukturat përgjegjëse, sasia mesatare e mbetjeve urbane që kërkon trajtim dhe depozitim final vlerësohet në rreth 21,000 ton në vit.

Kjo sasi paraqet një fluks të vazhdueshëm dhe të pandërprerë mbetjesh, i cili kërkon disponueshmëri të përhershme të infrastrukturës pritëse.

Për shkak të natyrës së këtij shërbimi, mungesa e një objekti funksional për pranimin dhe trajtimin e mbetjeve do të sillte menjëherë akumulim të mbetjeve në territorin administrativ, me pasojë të drejtpërdrejta në shëndetin publik, mjedis dhe funksionimin normal të shërbimeve publike.

Në këtë kuadër, garantimi i kapaciteteve të nevojshme për pranimin, peshimin, trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve përbën një kërkesë kritike operacionale dhe një detyrim të vazhdueshëm institucional të Bashkisë Krujë.

IV. ANALIZA INXHINIERIKE E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE DHE DOMOSDOSHMËRIA E SIGURIMIT TË KAPACITETEVE PËR TRAJTIM DHE DEPOZITIM FINAL

Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane përbën një sistem kompleks teknik, operacional dhe mjedisor, i ndërtuar mbi një seri hallkash të ndërlydhura funksionalisht, ku secila fazë varet drejtpërdrejt nga funksionimi i fazës pasuese.

Ky sistem përfshin:

- Gjenerimin e mbetjeve
- Grumbullimin në burim
- Transportin
- Pranimin në objektin përkatës
- Peshimin dhe regjistrimin
- Trajtimin paraprak
- Depozitimin final
- Monitorimin mjedisor gjatë operimit dhe pas mbylljes.

Nga pikëpamja inxhinierike, ndërprerja e cilësdo prej hallkave të mësipërme shkakton menjëherë mosfunksionim të të gjithë sistemit, duke sjellë akumulimin e mbetjeve në territor, rritjen e kostove operative dhe ekspozimin e popullsisë ndaj rreziqeve mjedisore dhe sanitare.

Për këtë arsye, disponueshmëria e kapaciteteve për trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve konsiderohet një komponent kritik i infrastrukturës publike mjedisore.

IV.1 Bilanci i masës së mbetjeve

Parimi bazë i projektimit dhe operimit të sistemeve moderne të menaxhimit të mbetjeve mbështetet në konceptin e bilancit të masës (Mass Balance), sipas të cilit çdo sasi mbetjesh e gjeneruar duhet të ketë një destinacion të identifikuar dhe të dokumentuar.

Për territorin administrativ të Bashkisë Krujë, gjenerimi mesatar i mbetjeve urbane vlerësohet në rreth 21,000 ton në vit.

Kjo sasi përfaqëson një fluks të vazhdueshëm materialesh të cilat duhet të:

- pranohen
- peshohen
- regjistrohen
- trajtohen sipas teknologjive të disponueshme
- depozitohen në mënyrë të kontrolluar.

Mungesa e kapaciteteve pritëse për këto sasi krijon menjëherë një deficit operacional në sistem, duke çuar në akumulimin progresiv të mbetjeve në territorin e bashkisë.

Për këtë arsye, kapaciteti i objektit pritës duhet të jetë i dimensionuar për të absorbuar në mënyrë të sigurt dhe të pandërprerë fluksin e mbetjeve të gjeneruara.

IV.2 Pranimi dhe kontrolli i mbetjeve

Pranimi i mbetjeve përbën pikën e parë të kontrollit teknik dhe mjedisor të sistemit.

Objekti pritës duhet të disponojë procedura të standardizuara për:

- identifikimin e origjinës së mbetjeve
- kontrollin vizual të ngarkesave
- verifikimin e kategorive të mbetjeve
- evidentimin e sasive hyrëse
- refuzimin e mbetjeve të palejuara.

Ky proces siguron që në objekt të pranohen vetëm mbetje që lejohen nga leja mjedisore dhe dokumentacioni teknik i operimit.

IV.3 Sistemi i peshimit dhe gjurmueshmërisë

Peshimi përbën mekanizmin kryesor të kontrollit sasior dhe financiar të shërbimit.

Çdo ngarkesë duhet të regjistrohet nëpërmjet urave të peshimit të certifikuara dhe të kalibruara sipas legjislacionit metrologjik.

Sistemi i peshimit duhet të sigurojë:

- saktësi matjeje
- regjistrim elektronik
- ruajtje të të dhënave
- gjurmueshmëri të plotë të çdo ngarkese.

Të dhënat e peshimit përbëjnë bazën për:

- faturimin e shërbimit
- raportimin institucional
- monitorimin e performancës
- auditimin teknik dhe financiar.

IV.4 Trajtimi paraprak i mbetjeve

Në rastet kur objekti disponon linja trajtimi, mbetjet mund t'i nënshtrohen proceseve të seleksionimit, reduktimit volumetrik, stabilizimit biologjik ose proceseve të tjera të rikuperimit.

Qëllimi i trajtimit paraprak është:

- reduktimi i volumit të mbetjeve
- rritja e shkallës së rikuperimit
- ulja e ndikimeve mjedisore
- optimizimi i kapaciteteve të depozitimit.

Megjithatë, pavarësisht nivelit të trajtimit, një pjesë e mbetjeve mbetet e destinuar për depozitim final në landfill ose objekt të autorizuar.

IV.5 Depozitimi final dhe kapaciteti rezidual

Depozitimi final përfaqëson fazën përfundimtare të ciklit të menaxhimit të mbetjeve.

Objekti pritës duhet të disponojë kapacitet rezidual të mjaftueshëm për të garantuar pranimin e sasive të kontraktuara gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Kapaciteti rezidual përkufizohet si volumi i disponueshëm që mbetet për t'u përdorur në qelizat operative të landfillit ose në strukturat e tjera të depozitimit.

Vlerësimi i këtij kapaciteti përbën një element kritik për sigurinë operationale dhe planifikimin afatgjatë të sistemit.

Në mungesë të kapaciteteve reziduale të mjaftueshme, ekziston rreziku real i ndërprerjes së pranimin të mbetjeve dhe i krijimit të situatave emergjente mjedisore.

IV.6 Menaxhimi i lixiviatit

Lixiviatit përfaqëson lëngun e krijuar nga infiltrimi i ujërave në masën e mbetjeve dhe nga proceset biologjike që zhvillohen brenda landfillit.

Për shkak të ngarkesës së lartë ndotëse, menaxhimi i lixiviatit përbën një nga komponentët më kritikë të operimit të objekteve të depozitimit.

Operatori duhet të disponojë:

- sistem drenazhimi
- rezervuarë grumbullimi
- infrastrukturë trajtimi ose largimi
- monitorim periodik të parametrave fizikë dhe kimikë.

Mosmenaxhimi i duhur i lixiviatit mund të shkaktojë ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

IV.7 Menaxhimi i biogazit

Proceset e biodegradimit të fraksionit organik të mbetjeve gjenerojnë biogaz, i përbërë kryesisht nga metan dhe dioksid karboni.

Për shkak të karakterit të tij potencialisht të ndezshëm dhe ndikimit në ndryshimet klimatike, biogazi duhet të kontrollohet përmes sistemeve të posaçme të grumbullimit dhe menaxhimit.

Objekti duhet të disponojë:

- puse gazi
- rrjet kolektorësh
- sisteme monitorimi
- sisteme djegieje ose shfrytëzimi energjetik, sipas rastit.

IV.8 Monitorimi hidro-gjeologjik dhe mjedisor

Objektet e trajtimit dhe depozitimit final duhet të monitorojnë vazhdimisht ndikimet e mundshme mbi mjedisin.

Monitorimi duhet të përfshijë:

- ujërat nëntokësore
- ujërat sipërfaqësore
- cilësinë e ajrit
- emetimet atmosferike
- zhurmat
- stabilitetin gjeoteknik të qelizave operative.

Ky monitorim siguron identifikimin në kohë të çdo devijimi nga parametrat e lejuar dhe mundëson marrjen e masave korrigjuese.

IV.9 Disponueshmëria operationale dhe vazhdimësia e shërbimit

Për shkak të natyrës së pandërprerë të gjenerimit të mbetjeve urbane, objekti pritës duhet të garantojë disponueshmëri të lartë operationale gjatë gjithë periudhës kontraktore.

Çdo ndërprerje e pranimi të mbetjeve krijon efekte të menjëhershme në të gjithë sistemin e pastrimit publik dhe cenon aftësinë e Bashkisë Krujë për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore.

Për rrjedhojë, sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme për pranimin, peshimin, trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve përbën një kërkesë kritike teknike dhe një kusht të domosdoshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit publik.

V. ANALIZA E RISKUT MJEDISOR, SHËNDETËSOR, TEKNIK, LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË RAST TË MOSSIGURIMIT TË SHËRBIMIT

V.1 QËLLIMI I ANALIZËS SË RISKUT

Analiza e riskut synon të vlerësojë pasojat e mundshme që mund të lindin si rezultat i mungesës së kapaciteteve për pranimin, peshimin, trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve urbane të gjeneruara në territorin administrativ të Bashkisë Krujë.

Për shkak të karakterit të vazhdueshëm të gjenerimit të mbetjeve urbane, çdo ndërprerje e zinxhirit funksional të menaxhimit të tyre përbën një rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin publik, mjedisin, funksionimin institucional dhe interesin publik.

Në këtë kuadër, vlerësimi i riskut kryhet duke analizuar ndikimet e mundshme në komponentët kryesorë të sistemit.

V.2 RISKU MJEDISOR

Mbetjet urbane përmbajnë një përzierje materialesh organike dhe inorganike të cilat, në rast depozitimi të pakontrolluar ose akumulimi të zgjatur në territor, mund të shkaktojnë ndikime të konsiderueshme në mjedis.

Mungesa e një objekti të autorizuar për trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve krijon mundësinë e:

- depozitimit të pakontrolluar të mbetjeve
- ndotjes së tokës
- ndotjes së ujërave sipërfaqësore
- ndotjes së ujërave nëntokësore
- përhapjes së mikroorganizmave patogjenë
- gjenerimit të aromave të pakëndshme
- shtimit të emetimeve të gazeve serrë
- degradimit të peizazhit dhe habitateve natyrore.

Veçanërisht shqetësues paraqitet rreziku i infiltrimit të lixiviatit në mjedis, i cili përmban ngarkesa të larta organike dhe kimike dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e ujërave dhe tokës.

Në mungesë të infrastrukturës së kontrolluar të depozitimit, ky risk konsiderohet i lartë.

V.3 RISKU PËR SHËNDETIN PUBLIK

Akumulimi i mbetjeve urbane në hapësira publike krijon kushte të favorshme për zhvillimin e vektorëve biologjikë dhe përhapjen e sëmundjeve.

Ndër pasojat kryesore identifikohen:

- shtimi i popullatave të brejtësve
- shtimi i insekteve dhe organizmave të tjerë bartës të sëmundjeve
- ndotja mikrobiologjike e mjedisit
- përkeqësimi i kushteve higjieno-sanitare
- rritja e ekspozimit të popullsisë ndaj agentëve biologjikë dhe kimikë.

Për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë midis menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së shëndetit publik, sigurimi i vazhdimësisë së këtij shërbimi konsiderohet një kërkesë prioritare e interesit publik.

V.4 RISKU TEKNIK DHE OPERACIONAL

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve funksionon mbi bazën e një zinxhiri të integruar procesesh.

Mungesa e objektit pritës për trajtimin ose depozitimin final të mbetjeve shkakton:

- ndërprerjen e transportit

- mbingarkimin e pikave të grumbullimit
- uljen e efikasitetit operacional
- rritjen e kostove operative
- vështirësi në menaxhimin e flotës së transportit
- krijimin e situatave emergjente operative.

Nga pikëpamja inxhinierike, sistemi nuk mund të funksionojë nëse mungon hallka përfundimtare e trajtimit dhe depozitimit final.

Për këtë arsye, disponueshmëria e kapaciteteve pritëse konsiderohet element kritik për sigurinë operationale të sistemit.

V.5 RISKU LIGJOR DHE RREGULLATOR

Mosgarantimi i menaxhimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi mund të ekspozojë Autoritetin Kontraktor ndaj përgjegjësive të ndryshme ligjore dhe administrative.

Pasojat e mundshme përfshijnë:

- masa administrative nga autoritetet kompetente
- procedura inspektimi dhe monitorimi
- përgjegjësi institucionale për mosushtim të funksioneve ligjore
- pretendime të mundshme për dëme mjedisore
- cenim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial.

Duke qenë se menaxhimi i mbetjeve është funksion ligjor i njësisë së vetëqeverisjes vendore, mosgarantimi i këtij shërbimi përbën një risk institucional me rëndësi të lartë.

V.6 RISKU EKONOMIK DHE FINANCIAR

Mungesa e një sistemi funksional për trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve mund të gjenerojë kosto shtesë të konsiderueshme.

Këto kosto mund të lidhen me:

- masa emergjente për largimin e mbetjeve
- pastrimin e depozitimeve të paligjshme
- rehabilitimin e zonave të ndotura;
- transportin në distanca më të gjata
- menaxhimin e situatave të emergjencës mjedisore.

Përvoja kombëtare dhe ndërkombëtare tregon se kostot e rehabilitimit pas ndotjes janë ndjeshëm më të larta se kostot e menaxhimit të rregullt dhe të planifikuar të mbetjeve.

V.7 RISKU SOCIAL DHE I INTERESIT PUBLIK

Menaxhimi i mbetjeve urbane është një nga shërbimet publike që perceptohet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe ndikon në cilësinë e jetës së komunitetit.

Ndërprerja ose degradimi i këtij shërbimi mund të sjellë:

- pakënaqësi të komunitetit
- ulje të cilësisë së jetesës
- ndikim negativ në aktivitetet ekonomike dhe turistike
- përkeqësim të imazhit institucional të autoritetit publik.

Për këtë arsye, vazhdimësia e shërbimit konsiderohet një element thelbësor i interesit publik.

V.8 VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I RISKUT

Nga analiza e mësipërme rezulton se mosgarantimi i kapaciteteve për pranimin, peshimin, trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve urbane paraqet risk të lartë mjedisor, shëndetësor, teknik, ligjor, financiar dhe institucional.

Për shkak të natyrës së vazhdueshme të gjenerimit të mbetjeve dhe detyrimeve ligjore të Bashkisë Krujë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, siguri i këtij shërbimi përbën një domosdoshmëri funksionale dhe një kusht të pazëvendësueshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit publik dhe mbrojtjen e interesit publik.

VI. ANALIZA E MUNGESËS SË ALTERNATIVAVE DHE JUSTIFIKIMI I ZGJIDHJES SË PËRZGJEDHUR

VI.1 PARIME TË PËRGJITHSHME

Menaxhimi i mbetjeve urbane është një shërbim publik i detyrueshëm dhe me karakter të vazhdueshëm, i cili nuk mund të ndërpritet apo pezullohet pa krijuar pasoja të drejtpërdrejta për shëndetin publik, mjedisin dhe funksionimin normal të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në përputhje me parimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, autoriteti përgjegjës duhet të sigurojë ekzistencën e kapaciteteve të mjaftueshme për trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve të gjeneruara në territorin e tij administrativ.

Për këtë arsye, përpara planifikimit të procedurës së prokurimit është e nevojshme të vlerësohen alternativat e disponueshme teknike, mjedisore dhe institucionale për përballimin e flukseve të mbetjeve të gjeneruara nga Bashkia Krujë.

VI.2 PAMUNDËSIA E NDËRPRERJES SË SHËRBIMIT

Mbetjet urbane gjenerohen çdo ditë dhe në mënyrë të pandërprerë nga aktivitetet familjare, tregtare, institucionale dhe ekonomike.

Ndryshe nga investimet apo shërbimet që mund të shtyhen në kohë, menaxhimi i mbetjeve përfaqëson një proces të vazhdueshëm operativ, ku çdo ndërprerje e hallkës së trajtimit dhe depozitimit final prodhon menjëherë pasoja në të gjithë sistemin.

Për rrjedhojë, Bashkia Krujë nuk disponon mundësinë funksionale të pezullimit të këtij shërbimi deri në identifikimin e një alternative të ardhshme, pasi vetë natyra e mbetjeve kërkon trajtim të përditshëm dhe të vazhdueshëm.

Nga pikëpamja teknike, sistemi duhet të funksionojë pa ndërprerje gjatë gjithë vitit kalendarik.

VI.3 KUFIZIMET E INFRASTRUKTURËS EKZISTUESE

Analiza e kapaciteteve ekzistuese tregon se infrastruktura e trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve është e kufizuar dhe e kushtëzuar nga faktorë teknikë, mjedisorë dhe administrativë.

Objektet e depozitimit operojnë mbi bazën e:

- kapaciteteve të projektuara
- kapaciteteve operative
- kapaciteteve reziduale
- kushteve të lejes mjedisore
- kushteve të sigurisë teknike dhe mjedisore

Kapaciteti rezidual i një landfilli ose objekti depozitimi përfaqëson volumin e mbetur të disponueshëm për depozitimin e mbetjeve deri në arritjen e kufijve të projektuar.

Ky tregues përbën një nga parametrat më të rëndësishëm për vlerësimin e qëndrueshmërisë së operimit afatgjatë.

Për pasojë, jo çdo objekt depozitimi mund të konsiderohet automatikisht alternativë e disponueshme, pasi pranimi i sasive shtesë duhet të mbështetet në kapacitete reale dhe të verifikueshme.

VI.4 KUFIZIMET MJEDISORE DHE LIGJORE

Objektet e trajtimit dhe depozitimit final operojnë në bazë të lejeve mjedisore dhe kushteve të veçanta të operimit.

Këto kushte përcaktojnë ndër të tjera:

- kategoritë e mbetjeve që mund të pranohen
- sasi të maksimale të lejuara
- kërkesat e monitorimit mjedisor
- masat për menaxhimin e lixiviatit
- masat për kontrollin e biogazit
- kufizimet operative.

Për këtë arsye, pranimi i mbetjeve në një objekt që nuk disponon autorizimet përkatëse ose kapacitetet e nevojshme do të ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe do të cenonte standardet e mbrojtjes së mjedisit.

Për më tepër, depozitimi i mbetjeve jashtë objekteve të autorizuara nuk përbën alternativë ligjore dhe nuk mund të konsiderohet opSION për Autoritetin Kontraktor.

VI.5 ANALIZA E OPSIONEVE TË MUNDSHME

Gjatë vlerësimit të alternativave të disponueshme janë konsideruar teorikisht disa opsione.

Opsioni i parë konsiston në depozitimin e mbetjeve në struktura të pakontrolluara ose jashtë objekteve të licencuara.

Ky opsion përjashtohet plotësisht pasi bie ndesh me legjislacionin kombëtar dhe standardet mjedisore.

Opsioni i dytë konsiston në pezullimin e përkohshëm të sistemit deri në identifikimin e një zgjidhjeje tjetër.

Ky opsion është teknikisht i pazbatueshëm për shkak të natyrës së vazhdueshme të gjenerimit të mbetjeve dhe riskut të lartë që krijon për shëndetin publik.

Opsioni i tretë konsiston në përdorimin e objekteve që nuk disponojnë kapacitet të mjaftueshëm rezidual ose autorizime të përshtatshme.

Edhe ky opsion nuk mund të konsiderohet i realizueshëm për shkak të kufizimeve teknike dhe mjedisore.

Opsioni i katërt konsiston në sigurimin e kapaciteteve të nevojshme përmes kontraktimit të operatorit ekonomik që disponon infrastrukturën, lejet dhe kapacitetet e nevojshme për pranimin, trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve.

Ky opsion rezulton të jetë alternativa e vetme funksionale, ligjore dhe teknikisht e realizueshme.

VI.6 INTERESI PUBLIK DHE VAZHDIMËSIA E SHËRBIMIT

Menaxhimi i mbetjeve urbane lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e interesit publik.

Mosgarantimi i këtij shërbimi do të cenonte:

- shëndetin publik
- sigurinë mjedisore
- cilësinë e jetës së qytetarëve
- funksionimin normal të shërbimeve publike
- përmbushjen e detyrimeve ligjore të Bashkisë Krujë.

Për këtë arsye, vazhdimësia e shërbimit përbën një kërkesë të domosdoshme institucionale dhe një kusht për ushtrimin normal të funksioneve të vetëqeverisjes vendore.

VI.7 JUSTIFIKIMI I ZGJIDHJES SË PËRZGJEDHUR

Në analizë të të gjithë faktorëve teknikë, mjedisorë, ligjorë dhe institucionalë rezulton se sigurimi i shërbimit të pranimi, peshimit, trajtimit dhe/ose depozitimit final të mbetjeve urbane nëpërmjet një operatori ekonomik që disponon kapacitetet përkatëse përbën zgjidhjen e vetme të realizueshme për garantimin e vazhdimësisë së sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Kjo zgjidhje garanton:

- përputhshmëri me legjislacionin në fuqi
- siguri mjedisore
- siguri operationale
- gjurmueshmëri të sasive të mbetjeve
- kontroll të kostove
- vazhdimësi të shërbimit publik.

Në këto kushte, procedura për sigurimin e shërbimit të pranimi, peshimit, trajtimit dhe/ose depozitimit final të mbetjeve urbane paraqitet e domosdoshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe garantimin e funksionimit normal të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në territorin administrativ të Bashkisë Krujë.

VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME TEKNIKE, MJEDISORE DHE JURIDIKE

VII.1 KONKLUZIONE

Nga analiza e kuadrit ligjor në fuqi, vlerësimi i situatës ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve urbane, analiza inxhinierike e sistemit, vlerësimi i riskut si dhe shqyrtimi i alternativave të disponueshme për trajtimin dhe depozitimin final të mbetjeve, rezulton se sigurimi i kapaciteteve për pranimin, peshimin, trajtimin dhe/ose depozitimin final të mbetjeve urbane përbën një domosdoshmëri objektive, të vazhdueshme dhe të paevitueshme për Bashkinë Krujë.

Menaxhimi i mbetjeve urbane nuk përfaqëson një aktivitet opsional apo të kushtëzuar nga disponueshmëria e burimeve infrastrukturore në një moment të caktuar, por një funksion ligjor të detyrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Bazuar në sasitë e mbetjeve të gjeneruara në territorin administrativ të Bashkisë Krujë, të vlerësuara në rreth 21,000 ton në vit, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e vazhdueshme të gjenerimit të tyre, rezulton se sistemi i menaxhimit të mbetjeve kërkon disponueshmëri të pandërprerë të kapaciteteve për trajtimin dhe depozitimin final.

Nga analiza e kryer rezulton gjithashtu se ndërprerja e shërbimit ose mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për pranimin dhe trajtimin e mbetjeve do të sillte pasoja të menjëhershme mjedisore, sanitare, ekonomike dhe institucionale, duke krijuar situata të papranueshme për interesin publik.

Vlerësimi teknik i alternativave të mundshme evidenton se opsionet e tjera nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për përballimin e sasive të gjeneruara, nuk disponojnë kapacitetet e nevojshme

operative ose nuk përmbushin kushtet ligjore dhe mjedisore të kërkuara për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Për pasojë, sigurimi i shërbimit nëpërmjet një operatori ekonomik që disponon infrastrukturën, kapacitetet teknike, autorizimet ligjore dhe lejet mjedisore përkatëse përbën alternativën e vetme të realizueshme dhe të përputhshme me legjislacionin në fuqi.

VII.2 KONKLUSIONE MJEDISORE

Nga pikëpamja mjedisore, garantimi i trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve në objekte të licencuara përbën kusht themelor për:

- parandalimin e ndotjes së tokës
- mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore
- kontrollin e emetimeve atmosferike
- menaxhimin e lixiviatit dhe biogazit
- minimizimin e ndikimeve negative mbi biodiversitetin dhe peizazhin.

Mosrealizimi i këtij shërbimi do të krijonte rrezik të konsiderueshëm për mjedisin dhe do të cenonte objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve.

VII.3 KONKLUSIONE TEKNIKE

Nga pikëpamja inxhinierike, sistemi i menaxhimit të mbetjeve funksionon si një zinxhir procesesh të ndërlidhura, ku çdo hallkë është e varur nga funksionimi i hallkës pasuese.

Pranimi, peshimi, trajtimi dhe depozitimi final përfaqësojnë komponentë kritikë të këtij sistemi dhe mungesa e tyre e bën të pamundur funksionimin normal të të gjithë skemës së menaxhimit të mbetjeve.

Për këtë arsye, disponueshmëria e kapaciteteve pritëse për mbetjet urbane konsiderohet pjesë e infrastrukturës kritike mjedisore dhe një element thelbësor për sigurinë operationale të sistemit.

VII.4 KONKLUSIONE JURIDIKE

Në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi, Bashkia Krujë mban përgjegjësinë ligjore për organizimin dhe garantimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin administrativ të saj.

Mosgarantimi i këtij shërbimi do të krijonte vështirësi serioze në ushtrimin e funksioneve ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe do të cenonte përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar në fushën e mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit.

Për rrjedhojë, sigurimi i shërbimit të trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve nuk përbën vetëm një nevojë funksionale, por edhe një detyrim të drejtpërdrejtë ligjor të Autoritetit Kontraktor.

VII.5 REKOMANDIME

Bazuar në analizat e paraqitura në këtë relacion rekomandohet:

1. Vijimi pa ndërprerje i sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin administrativ të Bashkisë Krujë.
2. Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për pranimin, peshimin, trajtimin dhe/ose depozitimin final të mbetjeve urbane në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore në fuqi.
3. Fillimi i procedurave përkatëse të prokurimit publik për kontraktimin e operatorit ekonomik që disponon kapacitetet teknike, infrastrukture dhe mjedisore të nevojshme për realizimin e këtij shërbimi.
4. Garantimi që operatori ekonomik të disponojë leje mjedisore të vlefshme, kapacitete operative të mjaftueshme, sistem të certifikuar peshimi dhe kapacitet rezidual të verifikueshëm për përballimin e sasive objekt kontrate.
5. Monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të kontratës dhe i përputhshmërisë së operatorit me kërkesat teknike, mjedisore dhe ligjore gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj.

Në përfundim, vlerësohet se sigurimi i shërbimit të pranimin, peshimit, trajtimit dhe/ose depozitimit final të mbetjeve urbane përbën një nevojë publike të domosdoshme, të vazhdueshme dhe të justifikuar plotësisht nga pikëpamja teknike, mjedisore dhe juridike, duke e bërë të nevojshëm ndërmarrjen e procedurave përkatëse për garantimin e vazhdimësisë së këtij shërbimi publik.

VII. ARGUMENTIMI I DETYRIMEVE LIGJORE TË BASHKISË DHE I NEVOJËS PËR GARANTIMIN E VAZHDIMËSISË SË SHËRBIMIT PUBLIK

VII.1 Detyrimet ligjore të Bashkisë në fushën e menaxhimit të mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve urbane përbën një funksion publik të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe realizohet në kuadër të përgjegjësisë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, bashkitë janë përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisit dhe interesit të komunitetit.

Po kështu, Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore me përgjegjësi të drejtpërdrejta për organizimin dhe garantimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin administrativ nën juridiksionin e tyre. Këto përgjegjësi nuk kanë karakter fakultativ, por përbëjnë detyrime ligjore të vazhdueshme dhe të pandërprera.

Për rrjedhojë, Bashkia Krujë ka detyrimin të sigurojë ekzistencën e një sistemi funksional për trajtimin dhe depozitim final të mbetjeve të gjeneruara në territorin e saj administrativ.

VII.2 Parimi i vazhdimësisë së shërbimit publik

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve bën pjesë në kategorinë e shërbimeve publike thelbësore.

Për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë në shëndetin publik dhe mjedis, ky shërbim duhet të garantohet në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje.

Ndryshe nga shërbimet apo investimet që mund të shtyhen në kohë, mbetjet urbane gjenerohen çdo ditë dhe kërkojnë trajtim të menjëhershëm.

Për këtë arsye, ndërprerja e hallkës së depozitimit final do të sillte bllokimin progresiv të të gjithë sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Nga pikëpamja teknike dhe institucionale, garantimi i vazhdimësisë së këtij shërbimi konsiderohet një detyrim themelor i Autoritetit Kontraktor.

VII.3 Mungesa e kapaciteteve alternative në dispozicion të Bashkisë

Bashkia Krujë nuk disponon infrastrukturë të vetën për trajtimin dhe depozitim final të mbetjeve urbane që të përmbushë kërkesat teknike, mjedisore dhe ligjore të legjislacionit në fuqi.

Ndërtimi dhe operimi i një landfilli sanitar ose i një impianti trajtimi kërkon:

- investime shumë të larta kapitale
- procedura komplekse mjedisore
- leje dhe autorizime të posaçme
- disponueshmëri të sipërfaqeve të përshtatshme
- monitorim afatgjatë pas mbylljes së objektit.

Për rrjedhojë, krijimi i një infrastrukture alternative nuk mund të konsiderohet zgjidhje e menjëhershme për garantimin e nevojave operative të Bashkisë Krujë.

VII.4 Kapacitetet reziduale dhe siguria operationale

Çdo objekt trajtimi ose depozitimi final operon brenda kufijve të kapaciteteve të tij të projektuara dhe të autorizuara. Pranimi i sasive shtesë të mbetjeve është i mundur vetëm në rast se objekti disponon:

- kapacitet rezidual të mjaftueshëm
- leje mjedisore të vlefshme
- sisteme funksionale për menaxhimin e lixiviatit
- sisteme funksionale për menaxhimin e biogazit
- infrastrukturë operative të përshtatshme.

Për këtë arsye, përzgjedhja e operatorit ekonomik duhet të mbështetet në prova të verifikueshme mbi disponueshmërinë e këtyre kapaciteteve.

VII.5 Domosdoshmëria e procedurës së prokurimit

Në kushtet kur:

- Bashkia Krujë ka detyrimin ligjor për garantimin e menaxhimit të mbetjeve urbane;
- mbetjet gjenerohen në mënyrë të vazhdueshme;
- mungesa e trajtimit dhe depozitimit final krijon risk të lartë mjedisor dhe shëndetësor;
- Bashkia nuk disponon kapacitete të veta për realizimin e këtij shërbimi;

rezulton se kontraktimi i operatorit ekonomik që disponon infrastrukturën dhe kapacitetet përkatëse përbën mekanizmin e vetëm të realizueshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit publik.

Për rrjedhojë, procedura e prokurimit për sigurimin e shërbimit të pranimi, peshimit, trajtimit dhe/ose depozitimit final të mbetjeve urbane konsiderohet e domosdoshme, proporcionale me nevojën publike dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

GRUPI I PUNES SE HARTIMIT TE DOKUMENATACIONIT TEKNIK: